

## Nga kualifikimet arsimore në kualifikimet profesionale

- **Kualifikimet arsimore** kanë një ndikim të madh në mundësitë profesionale në Gjermani. Për shembull, njeriu duhet të provojë kualifikimet e nevojshme arsimore kur aplikon për një vend pune ose formimi profesional. Për këtë atij i duhen kopje të certifikatave të shkollës. Edhe dëshmitë e trajnimit të mëtejshëm janë të dobishme.
- Për një profesion nuk mjaftojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme. Zakonisht duhet edhe një **kualifikim profesional**. Ky është një vërtetim me shkrim që personi ka kryer një kualifikim profesional.
- Për fillimin e një formimi profesional zakonisht nevojitet një kualifikim i caktuar shkollor. Kjo ndryshon sipas profesionit.
- Në Gjermani ka pesë mundësi për kualifikim shkollor: certifikata e përfundimit të shkollës së mesme të ulët, certifikata e përfundimit të shkollës së mesme, kualifikimi i hyrjes në shkollën e lartë teknike, kualifikimi i hyrjes në arsimin e lartë specifik për lëndën dhe kualifikimi i përgjithshëm të hyrjes në arsimin e lartë.
- Çdo kualifikim shkollor në Gjermani ofron përherë një mundësi të mëtejshme kualifikimi.
- **Kualifikimi profesional** dëshmon me shkrim njohuritë dhe aftësitë në një profesion. Kualifikimi profesional u mundëson të rinjve të gjejnë punë me përgjegjësinë e duhur dhe pagesë të përshtatshme. Kualifikimi profesional ofron edhe mundësitë për ngritjen në detyrë.
- Edhe nëse e keni ndjekur tashmë shkollën në një vend tjetër, ju duhet një **certifikatë e përfundimit të shkollës që njihet në Gjermani**. Kjo vlen edhe për kualifikimet profesionale.
- Nëse keni pyetje në lidhje me njohjen e kualifikimeve arsimore dhe profesionale, mund të kontaktoni personat ose institucionet e mëposhtme: Punonjësit socialë, përkthyesit e certifikuar, Shërbimin e Migracionit të Rinjve (jmd), Qendrën e Informacionit për Karrierën (BIZ), ...
- Nëse fëmijët kanë një dëshirë konkrete për profesion, është e rëndësishme që prindërit të informohen bashkë me fëmijët: Si quhet profesioni? Cili rrugëtim arsimor të çon drejt këtij profesioni? Çfarë kualifikimesh profesionale i duhen fëmijës tim?
- Çdo njeri zgjedh rrugëtimin e vet arsimor. Ngaqë fëmijët kanë interesa të ndryshme dhe njohuri apo aftësi të ndryshme, mund të zgjedhin një shkollë si dhe një profesion, që u përshtatet atyre.
- Gjendja ekonomike dikton faktin nëse mund të fitoni mirë nga një profesion i caktuar. Nëse një profesion kërkohet gjerësisht, atëherë zakonisht fitohet mirë. Nëse profesioni është shumë popullor dhe shumë njerëz kualifikohen për të, fitimet mund të bien përsëri.
- Profesionet kërkojnë rrugëtime të ndryshme arsimore, kualifikime arsimore dhe kualifikime profesionale. Jo për të gjitha profesionet kërkohet një kohë e gjatë formimi. Profesionet kanë kritere të ndryshme.
- Zakonisht në një fushë të specializuar ka shumë profesione të ndryshme.

- Për shembull, në sektorin e kujdesit shëndetësor mund të merrni kualifikime profesionale si specialist i mjekësisë së brendshme, asistent mjekësor, punonjës shëndetësor dhe infermier, asistent laborator.
- Në industrinë e ndërtimit ka kualifikime profesionale si vizatues ndërtimi, murator, inxhinier dhe shumë profesione të tjera specifike.